



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**KOMUNA E RAHOVECIT**

---

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenia Sociale  
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje

-VI- Nr. i prot. 252 Më 31.12.2024  
Br. prot. 252 Dt. 31.12.2024  
RAHOVEC - ORAHOVAC

# PLAN I PUNËS

---

# 2025

---

2025

# PËRMBAJTJA

DREJTORIA PËR SHËNDETËSISË DHE PËRKUJDESJE SOCIALE.....	2
Prioritetet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale .....	2
Tremujori i parë: janar, shkurt, mars .....	2
Tremujori i dytë: prill, maj, qershor .....	2
Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator .....	3
Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor.....	3
Synimet e DSHPS-së .....	3
Sektori i shëndetësië .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Sektori i mirëqenies sociale.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtorja për DSHPS, për vitin 2025 planifikon rritjen e kapaciteteve të kuadrove mjekësor, dhe infermierëve, modernizimin e shërbimeve, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit 2025, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

DSHPS këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në shëndetësi
- Përkrahjes së mjekëve dhe personelit shëndetësor
- Shërbimeve këshillimore për pacientët
- Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe organizatat që veprojnë në fushën e shëndetësisë organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

### Prioritetet e Drejtorisë së Shëndetësisë, 2025

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MSH-së, për aplikim të fondeve dhe të granteve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

#### Tremujori i parë: janar, shkurt, mars 2025

Qysh në Janar DSHPS-ja, do të përgatitet që të jetë e gatshme të përballoj fluksin e pacientëve në raste të gripave virale, po ashtu dy QMF-të, në dy lokalite të mdhaja në Krushë të Madhe, dhe Ratkoc dotë vazhdojmë me dy ndërime duke ofruar shërbime mjekësore qytetarëve në nevojë, po ashtu në këto dy QMF-të, dotë bëjmë përojekje për modernizim të shërbimeve, me analizat laboratorike dhe të shërbimeve të Rengenit, dotë ofrohen shërbimet e rëntgenit edhe ne dy QMF-të, në Krushe Të Madhe, dhe Ratkoc, si dhe ofrimin e shërbimeve stomatologjike në të gjitha QMF-të, e komunës së Rahovecit

Duke u bazuar në planin e prokurimit, do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale si dhe përcjellja e projekteve që janë në vazhdim me theks të veçantë renovimi i QKMF-së, po ashtu dotë bëjm zgjidhjen e problemit të QMF-së, në Fortes ndërtimin e objektit të ri përshkak se objekti aktual është jashtë funksionit si pasoj e vërshimeve te muajit shtator 2022 ( si pas vlersimit te komisionit te formuar me vendim të kryetarit per vlerësim te dëmeve ne te shakaktuara ne objektin ekzistues ne QMF, Fortes),po ashtu edhe renovimin e QMF-së, në Apterush, po ashtu fokusi dote jet edhe mirëmbajtja e mjeteve mjekësore, dhe të objekteve shëndetësore.

Në këtë tremujor të parë të vitit planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor i cili është i parapar të në qdo tremujor.

#### Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Duke shpresuar që të jemi në një vijë me Ministrinë e linjës ku kemi aktivitetet e ndërldhura, pregatitja e stafit për emergjencën dotë trajnohen ekipet e veqanta për njësin e emergjencës

Periudha kyçe në këtë vitë është kjo, funksionalizimi i plotë i renovimit të objektit të QMF-ve, në të cilën qytetarët e komunës sonë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes së shërbimeve

mjekësore në të gjithë sektorët e shëndetësisë si: sektori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, si në gjinakologji, stamotologji, vaksinim e shërbime tjera.

Përcjellja e projekteve kapitale në terren duke shpresuar në përmirësimin e kushteve atmosferike do të vazhdojnë ta përcjellin këtë periudhë tremujore.

Në këtë periudh do të ndërmarrim masa parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të komunës sonë, dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektim të hapsirave me qëllim të mbrojtjes nga pickimin e riqnave duke ditur se shumë herë si komune kemi qenë si vatër e infeksion nga riqnat.

Në këtë tremujor të dytë të vitit planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

#### **Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator 2025**

Periudha e tretë të vitit dotë jetë periudha ku dotë jetë në funksion të plotë objekti i rinovuar i QKMF-dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët në nevojë, furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, po ashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë të subvencioneve për ndihma momentale.

Në këtë tremujor të tretë të vitit planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

#### **Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor 2025**

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri, si dhe planifikimi i buxhetit për vitin paraprak.

Në këtë tremujor të katërt të vitit planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësor.

#### **Synimet e DSHPS-së**

Përkushtim i veçantë i DSHPS-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore për qytetarët e komunës sonë, në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore
- Intervenimi, meremetim të QMF-ve, dhe AMF-ve.
- Modernizim të shërbimeve mjekësore.

## Sfidat e DSHPS-së 2025

Sfida kryesore e DSHPS është mungesa e stafit mjekësor, ku kemi munges te theksuar te mjekëve, stomatologve, infermiereve.

Po ashtu si sfida e madhe është edhe hapja e repartit të dializës edhe pse nuk është kompetenc e DSHPS, duke ditur se shërbime të dializës janë shërbime terciare, komuna përkatësisht DSHPS-ja, ka pasur një marveshje me QKUK-në, për hapje e repartit të dializës në objektin e QKMF-së, si njësi satelite e repartit të dializës të spitalit regional të Prizrenit.



DSHPS

Saranda Sallteku